



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

N. Prot. 256

Tiranë më 28/8/2025

Rregullore e Procedurave të Pranimiit për Program të Dytë Studimi në Universitetin Katolik Zoja e Këshillit të Mirë,

Viti Akademik 2025 - 2026

Informacion i përgjithshëm

Procedurat e pranimit në një program të dytë studimi në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" (në vijim UKZKM) miratohen në përputhje me Urdhrin nr.12, të datës 30.06.2023, të publikuar në faqen zyrtare të universitetit: www.unizkm.al.

Për t'u pranuar në një Program të dytë Studimi në UKZKM kandidatët duhet:

- të jenë të pajisur me një diplomë të lëshuar nga një universitet i akredituar;
- të kenë përfunduar studimet universitare në programe të të njëjtit cikël me atë për të cilin po bëhet kërkesa, p.sh.: Program studimi "Bachelor" → Program studimi "Bachelor" (psh. Infermieri → Fizioterapi); Program i integruar studimi i ciklit të dytë → Program i integruar studimi i ciklit të dytë (psh. Farmaci → Mjekësi).

Kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e sipërpërmendura do të konsiderohen "Kandidatë të pakualifikuar për t'u regjistruar në një program të dytë studimi" dhe do të kenë ende mundësinë e regjistrimit në vitin e parë të studimeve sipas procedurave të parashikuara në Udhëzimin nr.10, datë 15.05.2019, i ndryshuar.

Kandidatët e huaj që nuk e kanë përfunduar arsimin e mesëm në Itali ose në një shkollë të mesme ku gjuha zyrtare e mësimi nuk është gjuha italiane, duhet të kenë Certifikatën e mbrojtjes së gjuhës italiane të paktën në nivelin B1, siç parashikohet në Udhëzimin Nr. 52 datë 03/12/2015, ose të kryejnë testimin mbi njohjen e Gjuhës Italiane të organizuar nga UKZKM në momentin e regjistrimit.

Kandidatët nuk mund të regjistrohen njëkohësisht në disa programe studimi në të njëjtin vit akademik, në universitete publike dhe/ose private, shqiptare.

Kreu I- Procedurat e pranimit në një program të dytë studimi për kandidatët shqiptarë

1. Si të aplikoni për program të dytë studimi

Sipas Urdhrit të përbashkët nr.157, datë 03.06.2025 të QSHA-RASH dhe Udhëzimit nr. 12 dt. 30.06.2023, kandidatët e interesuar mund të aplikojnë për regjistrim në një program të dytë studimi në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë të UKZKM nga data 01 Shtator deri në datën 12 shtator 2025 sipas hapave të mëposhtëm:

- Të regjistrohen online në portalin e Universitetit: <http://admissions.unizkm.al/#/>
- Të përzgjedhin zërin: "Secondo corso di laurea";



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

- Të plotësojnë procedurën duke ngarkuar online kopje elektronike në format PDF (të skanuara në format pdf/A) dokumentacionin e mëposhtëm për regjistrimin në një program të dytë studimi:
- kopje të njehsuar me origjinalit të diplomës dhe listën e notave/suplementin e diplomës, të studimeve të arsimit të lartë të kryera më parë;
- vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);
- kopje e njësuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme (për kandidatin që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011). Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në DRAP/ZVAP përkatëse si dhe listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;
- kopje të dokumentit të identifikimit;

Shënim: Dokumentacioni duhet të përkthehet në gjuhën italiane ose në gjuhën angleze para se të ngarkohet në portal.

Pas ngarkimit të dokumentacionit të mësipërm, do të kryhen verifikimet përkatëse për çdo kandidat. Kandidati mund të verifikojë statusin e tij të aplikimit në profilin e tij online në portalin: <http://admissions.unizkm.al/>.

2. Procedurat e Regjistrimit në Procesin e Pranimit në Programin e Dytë të Studimit

2.1- Për programet e studimit në Odontoiatri dhe Proteza Dentare:

Kandidatët që konsiderohen të kualifikuar pas verifikimit të dokumentacionit të ngarkuar në portalin <http://admissions.unizkm.al/>, duhet të kryejnë testimin e pranimit pranë UKZKM për kuotat e parashikuara për pranim në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë, në datat e mëposhtme:

Programi i studimit	Data	Ora
Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në Odontoiatri dhe Proteza Dentare	24/09/2025	10:00

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të pikëve të grumbulluara në testimet e mëposhtme dhe nga vlerësimi i mesatares së përgjithshme të shkollës së mesme:

1. Testim me shkrim në italisht, i organizuar në formë pyetjesh me alternativa, për të vlerësuar njohuritë në Shkencat Natyrore (Biologji, Kimi, Matematikë, Fizikë)	30 pikë
2. Testim mbi njohjen e gjuhës italiane	20 pikë
3. Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë
Totali	80 pikë



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Një komision i veçantë didaktik do të vlerësojë karrierën universitare të kandidatëve të shpallur fitues të testimit të pranimit. Komisioni Didaktik bën njohjen/njehsimin e plotë apo të pjesshëm të krediteve ECTS/të provimeve të shlyera dhe përcakton vitin specifik ku do të regjistrohet kandidati, në qoftë se programi i studimit i përfunduar më parë është i të njëjtës fushë ose të një fushe të përafërt me programin e studimit ku ai aplikon. Në rast të kundërt, procedohet me regjistrimin e kandidatit në vit të Parë (I).

Brenda datës 12 shtator 2025, ora 16:30, kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi dhe do të marrin pjesë në testime, duhet të paguajnë tarifën prej 2000 lekë për pjesëmarrjen në testimin e pranimit, si më poshtë:

- pranë filialeve të Bankës Intesa SanPaolo në llogarinë¹ me këto të dhëna:
Përfituesi: Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)
IBAN AL06208112040000030694935304 për pagesat në Lekë
- me kartë krediti online në portalin e universitetit: <https://admissions.unizkm.al/#/auth/signin>
- pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", e disponueshme nga e hëna në të premte, nga ora 08:00-16:30.

2.2- Për programet e studimit në Arkitekturë dhe Ekonomi Ndërmarrjeje

Dokumentacioni i kandidatëve që aplikojnë për program të dytë studimi do t'i paraqitet Komisionit Didaktik ad hoc të secilit program për vlerësimin e studimeve universitare të kryera më parë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara për çdo kandidat nga mesatarja e përgjithshme së shkollës së mesme dhe nga studimet universitare të kryera më parë:

1.	Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	50 pikë
2.	Studimet universitare të kryera më parë (kredite të njohura)	50 pikë
	Totali	100 pikë

3. Listat e renditjes

Listat e renditjes së aplikantëve do të publikohen brënda **datës 26 Shtator 2025** në faqen zyrtare të UKZKM <https://www.unizkm.al/>. Kandidatët mund të përjashtohen nga lista e renditjes nëse gjenden parregullsi në dokumentacionin e paraqitur për aplikim.

¹ Ju lutemi të specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin e studimit për të cilin po kryeni pagesën. Ditën e testimit duhet të paraqisni kopje të mandat-pagesës duke qënë se koha e mbërritjes së pagesave është e kufizuar.



4. Procesi i regjistrimit

Sipas Urdhrit të përbashkët nr.157, datë 03.06.2025 të QSHA-RASH dhe Udhezimit nr. 12 dt. 30.06.2023, kandidatët e shpallur fitues në bazë të rezultateve dhe kuotave të parashikuara, duhet të kryejnë regjistrimin (i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore sipas afatit të përcaktuar në kalendar, **në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit**) nga data **06 Tetor deri më datë 10 Tetor 2025**, duke dorëzuar pranë Sekretarive Mësimore përkatëse dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

4.1 Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në IAL (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

- Emrin, atësinë, mbiemrin;
- datëlindjen;
- vendlindjen;
- shtetësinë;
- numrin e matrikullimit që ka pasur në IAL-në përcjellëse;
- emrin e institucionit të arsimit parauniversitar të mesëm të lartë/IAL-së ku ka kryer studimet përpara ndjekjes së këtij programi studimi;
- ID-në e Maturës Shtetërore / nr. Regj. të veçantë1;
- numrin personal të identitetit;
- datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja;
- emërtimin e programit të studimit dhe fakultetit përkatës;
- ciklin dhe formën e studimit;
- datën e ndërprerjes së studimeve.

5.2 Mandatin e kryerjes së pagesës së këstit të parë apo të këstit të plotë të tarifës vjetore të studimit (urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë, shkarkohet nga portali studentor portal.unizkm.al, zëri "Tariffe");

5.3 dy fotografi personale.

Dokumentacioni duhet të jetë fotokopje e noterizuar. Në rastet kur dokumentacioni vjen nga një Universitet i huaj duhet të jetë i pajisur edhe me vulë Apostile. Dokumentacioni i dorëzuar për regjistrimin përfundimtar duhet të jetë identik me versionin elektronik të përdorur në regjistrimin për konkurs.



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Kandidatët që e kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit të cilët do të kenë mangësi në dorëzimin e dokumentit do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të lejohen të futen në provimet e semestrit të parë.

Regjistrimi me rezervë nënkupton se mosrespektimi i kushteve brenda afateve të parashikuara nga Udhëzimet e ministrisë mund të sjellë për pasojë mos pajisjen me statusin student, e për rrjedhojë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë. Kandidatët fitues me diplomë të huaj, në këto programe studimi, i nënshtrohen procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, si të gjithë kandidatët e tjerë, por regjistrimi i këtyre kandidatëve fitues bëhet me rezervë, pa pasur domosdoshmërisht në momentin e regjistrimit dokumentin e njohjes dhe njësimit të lëshuar nga QSHA.

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studenti: portal.unizkm.al);
- Kontrata e regjistrimit;
- formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 3, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi; 2.
- deklaratën sipas shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi:

Kreu II-Procedurat e pranimit në një program të dytë studimi për kandidatët e huaj

1. Si të aplikoni për program të dytë studimi

Sipas Urdhrit të përbashkët nr.157, datë 03.06.2025 të QSHA-RASH dhe Udhëzimit nr. 12 dt. 30.06.2023, kandidatët e interesuar mund të aplikojnë për regjistrim në një program të dytë studimi në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë të UKZKM nga data 01 Shtator deri në datën 12 Shtator 2025 sipas hapave të mëposhtëm:

- Të regjistrohen *online* në Portalin e Universitetit: <http://admissions.unizkm.al/#/>
- Të përzgjedhin zërin: “**Secondo corso di laurea**”
- Të plotësojnë procedurën duke ngarkuar online kopje elektronike në format PDF (të skanuara në format pdf/A) dokumentacionin e mëposhtëm për regjistrimin në një program të dytë studimi:

1. kopje të njehsuar me origjinalit të diplomës dhe listën e notave/suplementin e diplomës, të
2. studimeve të arsimit të lartë të kryera më parë;
3. vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);
4. Kopje të njehsuar me origjinalin të Diplomës e Shkollës së Mesme;
5. Certifikatë e Diplomës së shkollës së mesme me të dhënat përkatëse (provimi me shkrim, provimi me gojë, kreditet, pikët shtesë), që përbëjnë vlerësimin e përgjithshëm të Maturës Shtetërore. Në



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

mungesë të certifikatës, mund të bashkëlidhet një vërtetim i vulosur dhe nënshkruar nga shkolla e mesme me vlerësimin e përgjithshëm të Maturës Shtetërore dhe rezultatet e detajuara (provim me shkrim, provim me gojë, etj);

6. Dëftesat e të gjitha viteve të Shkollës së Mesme;
7. kopje të dokumentit të identifikimit;
8. Pagesën e tarifës prej 50 € për aplikim² me mënyrat e mëposhtme:
 - Me transferte bankare në llogarinë³ me këto të dhëna:
Përfituesi: Zoja e Këshillit të Mire (Universiteti Katolik)
Banka: Intesa San Paolo Bank
BIC/Swift: USALALTR
IBAN: AL60208112040000030694935302
 - me kartë krediti online në portalin e universitetit: <https://admissions.unizkm.al/#/auth/signin>
 - pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", e disponueshme nga e hëna në të premte, nga ora 08:00-16:30.

Shënim: Dokumentacioni duhet të përkthehet në gjuhën italiane ose në gjuhën angleze para se të ngarkohet në portal.

Pas ngarkimit të dokumentacionit të mësipërm, do të kryhen verifikimet përkatëse për çdo kandidat. Kandidati mund të verifikojë statusin e tij të aplikimit në profilin e tij online në portalin: <http://admissions.unizkm.al/>.

2. Procedurat e pranimi për kandidatët shtetas të huaj

2.1 Për programet e studimit në Odontoiatri dhe Proteza Dentare:

Kandidatët që rezultojnë të kualifikuar pas verifikimit të dokumentacionit të ngarkuar në Portalin <http://admissions.unizkm.al/>, duhet të kryejnë testimin e pranimi në UKZKM për kuotat e parashikuara për pranimet në programin e studimit në Fakultetin e Mjekësisë, në datat e mëposhtme:

- Testimi i pranimi do të kryhet në datën:

²Komisionet bankare paguhen nga dërguesi. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi është i pavlefshëm.

³ Ju lutemi të specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin e studimit për të cilin po kryeni pagesën. Ditën e testimit duhet të paraqisni kopje të mandat-pagesës duke qënë se koha e mbërritjes së pagesave është e kufizuar.



Programi i studimit	Data	Ora
Programi i integruar i studimit "Master i Shkencave" në <i>Odontoiatri dhe Proteza Dentare</i>	24/09/2025	10:00

Vlerësimi i kandidatëve nga vendet e BE-së dhe jo BE do të bëhet në bazë të pikëve të mëposhtme:

1. Testim me shkrim në italisht, i organizuar në formë pyetjesh me alternativa, për të vlerësuar njohuritë në Shkencat Natyrore (Biologji, Kimi, Matematikë, Fizikë)	30 pikë
2. Testim mbi njohjen e gjuhës italiane	20 pikë
3. Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë
Totali	90 pikë

Brenda datës 15 shtator 2025 ora 16.30, kandidatët nga vendet e BE-së dhe jo BE-së që janë kualifikuar për program të dytë studimi dhe do të marrin pjesë në testimet e pranimit në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë duhet të **paguajnë tarifën prej 100 euro⁴ për pjesëmarrjen në testim** (pagesa do të kryhet me të njëjtat mënyra të përdorura për të paguar tarifën e transferimit 50 Euro).

Një komision i veçantë didaktik do të vlerësojë karrierën universitare të kandidatëve të shpallur fitues të testimit të pranimit. Komisioni Didaktik bën njohjen/njehsimin e plotë apo të pjesshëm të krediteve ECTS/të provimeve të shlyera dhe përcakton vitin specifik ku do të regjistrohet kandidati, në qoftë se programi i studimit i përfunduar më parë është i të njëjtës fushë ose të një fushe të përafërt me programin e studimit ku ai aplikon. Në rast të kundërt, procedohet me regjistrimin e kandidatit në vit të Parë (I).

2.2 Në programet e studimit në Arkitekturë dhe Ekonomi Ndërmarrjeje:

Dokumentacioni i kandidatëve që aplikojnë për program të dytë studimi do t'i paraqitet Komisionit Didaktik ad hoc të secilit program për vlerësimin e studimeve universitare të kryera më parë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara për çdo kandidat nga mesatarja e përgjithshme së shkollës së mesme dhe nga studimet universitare të kryera më parë:

1.	Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	50 pikë
2.	Studimet universitare të kryera më parë (kreditet e njohura)	50 pikë
	Totali	100 pikë

⁴ Komisionet paguhen nga dërguesi. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi është i pavlefshëm.



3. Listat e renditjes

Listat e renditjes së aplikantëve do të publikohen brënda **datës 26 Shtator 2025** në faqen zyrtare të UKZKM <https://www.unizkm.al/>. Kandidatët mund të përjashtohen nga lista e renditjes nëse gjenden parregullsi në dokumentacionin e paraqitur për aplikim.

4. Procesi i regjistrimit

Sipas Urdhrit të përbashkët nr.157, datë 03.06.2025 të QSHA-RASH dhe Udhezimit nr. 12 dt. 30.06.2023, kandidatët shpallur fitues në bazë të rezultateve dhe kuotave të parashikuara, duhet të kryejnë regjistrimin (i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore sipas afatit të përcaktuar në kalendar, **në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit**) nga data **06 deri me datë 10 Tetor 2025**, duke dorëzuar pranë Sekretarive Mësimore përkatëse dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

4.1 Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në IAL (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

Emrin, atësinë, mbiemrin;

datëlindjen;

vendlindjen;

shtetësinë;

numrin e matrikullimit që ka pasur në IAL-në përcjellëse;

emrin e institucionit të arsimit parauniversitar të mesëm të lartë/IAL-së ku ka kryer studimet përpara ndjekjes së këtij programi studimi;

ID-në e Maturës Shtetërore / nr. Regj. të veçantë1;

numrin personal të identitetit;

datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja;

emërtimin e programit të studimit dhe fakultetit përkatës;

ciklin dhe formën e studimit;

datën e ndërprerjes së studimeve.

4.2 Mandatin e kryerjes së pagesës së kështit të parë apo të kështit të plotë të tarifës vjetore të studimit (urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë, shkarkohet nga portali studenti portal.unizkm.al, zëri "Tariffë");

4.3 dy fotografi personale.



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Dokumentacioni duhet të jetë fotokopje e noterizuar. Në rastet kur dokumentacioni vjen nga një Universitet i huaj duhet të jetë i pajisur edhe me vulë Apostile. Dokumentacioni i dorëzuar për regjistrimin përfundimtar duhet të jetë identik me versionin elektronik të përdorur në regjistrimin për konkurs.

Kandidatët që e kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit të cilët do të kenë mangësi në dorëzimin e dokumentit do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të lejohen të futen në provimet e semestrit të parë. Regjistrimi me rezervë nënkupton se mosrespektimi i kushteve brenda afateve të parashikuara nga Udhëzimet e ministrisë mund të sjellë për pasojë mos pajisjen me statusin student, e rrjedhojë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik. Kandidatët fitues me diplomë të huaj, në këto programe studimi, i nënshtrohen procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, si të gjithë kandidatët e tjerë, por regjistrimi i këtyre kandidatëve fitues bëhet me rezervë, pa pasur domosdoshmërisht në momentin e regjistrimit dokumentin e njohjes dhe njësimit të lëshuar nga QSHA.

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studenti: portal.unizkm.al);
- Kontrata e regjistrimit;
- formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 3, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- deklaratën sipas shtojcës nr. 1, të këtij udhëzimi;

Shënim: Ju kujtojmë se shtetasit e huaj mund të qëndrojnë lirisht në Shqipëri për një periudhë maksimale prej 90 ditësh në një gjashtëmujor (gjashtëmujori llogaritet nga dita e hyrjes së parë në vend dhe 90 ditët llogariten duke shtuar të gjitha periudhat e qëndrimit në Shqipëri, edhe nëse jo të njëpasnjëshme). Ata që synojnë të qëndrojnë në territorin shqiptar për më shumë se 90 ditë në një gjashtëmujor, duhet të paraqesin kërkesë për leje qëndrimi pranë autoriteteve kompetente shqiptare dhe duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore një kopje të noterizuar të lejes së qëndrimit në Shqipëri.

Rektori
Prof. Leonardo Palombi

